



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Shkup, 21 tetor 2024

Njoftim për shtyp

Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: shtator 2024

- **Paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})**, në shtator 2024, shënoi rënie mujore prej 1,2%, kryesisht si rezultat i uljes së depozitave afatshkurtra dhe parave të depozitave, me kontribut më të vogël në rënien e parasë së gatshme në qarkullim, dhe në kushtet e rritjes së depozitave afatgjata deri në dy vjet. Në baza vjetore, paraja e gjerë është rritur për 6,7% për shkak të parave të depozituara më të larta, depozitave afatgjata deri në dy vjet dhe parave të gatshme në qarkullim, ndërsa depozitat afatshkurtra kanë shënuar rënie.
- **Totali i depozitave³**, në shtator është ulur për 0,4% në baza mujore, në tërësi si rezultat i rënies së depozitave të sektorit korporativ, ndërkohë që depozitat e amvisërive shënuan rritje. Rritja vjetore e totalit të depozitave është 8,8%, që vjen si pasojë e rritjes së depozitave të të dy sektorëve, me kontribut dukshëm më të lartë të sektorit të “amvisërisë”.

Tabela 1. Paraja e gjerë dhe totali i depozitave të sektorit joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)					ndryshimet vjetore (në %)					ndryshimet mujore (në %)				
	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024
Paraja e gjerë M4	595,151	591,336	607,881	621,179	616,771	8.7	9.5	7.6	9.2	8.6	4.3	-0.7	0.5	1.5	-0.7
Paraja e gjerë M3	529,264	521,804	535,985	546,336	540,047	5.9	6.6	5.4	7.4	6.7	4.5	-0.9	0.4	1.5	-1.2
<i>nga të cilat:</i>															
Paratë në qarkullim	50,002	49,336	51,377	53,049	52,062	5.3	8.6	7.6	11.5	9.9	7.5	1.5	2.2	0.6	-1.9
Depozitat e parave	211,402	202,074	211,126	214,718	212,711	12.4	11.4	8.8	11.8	11.3	10.0	-1.9	0.3	1.4	-0.9
Depozitat afatshkurta	215,860	215,551	215,501	218,046	212,930	0.6	1.0	0.1	-0.3	-2.0	-0.5	-1.1	0.2	1.2	-2.3
Depozitat afatshkurta deri në 2 vjet	51,999	54,842	57,981	60,523	62,345	4.5	10.8	12.7	20.1	23.9	2.1	1.4	0.0	3.6	3.0
Totali i depozitave	534,241	531,140	544,683	557,764	555,602	8.7	9.3	7.2	9.1	8.8	4.0	-0.9	0.4	1.9	-0.4
<i>nga të cilat:</i>															
Sektori korporativ	161,432	150,674	153,830	158,878	158,056	13.2	12.2	4.7	3.8	4.7	6.6	-2.4	1.0	3.1	-0.5
Në denarë	109,266	100,009	103,684	106,847	107,476	15.8	12.5	5.6	5.7	7.9	8.5	-3.6	1.7	3.7	0.6
Në valutë të huaj	52,166	50,664	50,146	52,032	50,580	8.2	11.4	2.8	0.1	-1.5	2.7	0.1	-0.4	1.7	-2.8
Amvisëritë	348,745	354,741	364,432	371,675	372,219	7.9	8.7	8.9	12.0	11.2	3.5	0.1	0.0	1.2	0.1
Në denarë	173,543	177,631	184,627	190,570	190,026	11.8	13.7	13.1	19.9	18.0	6.4	0.6	-0.6	1.9	-0.3
Në valutë të huaj	175,201	177,109	179,805	181,106	182,194	4.4	4.0	4.8	4.8	4.9	0.7	-0.3	0.5	0.6	0.6

Burimi: BPRMV.

¹ Duke filluar nga qershori 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetar M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

² Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetar M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

³ Totalin e depozitave e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetar M4, të cilat i takojnë sektorit korporativ, amvisërive, institucioneve tjera financiare, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive dhe vetëqevirsjes lokale.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- **Totali i kredive**, në shtator shënoi rritje mujore prej 0,4%, e cila është tërësisht rezultat i rritjes së kreditimit të sektorit të “amvisërisë”. Në bazë vjetore, totali i kredive është rritur për 7,5% si ndikim i rritjes së kreditimit në dy sektoret, me kontribut pak më të theksuar të sektorit të “amvisërive”.


Tabela 2. Totali i kredive në sektorin joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)					ndryshimet vjetore (ao %)					ndryshimet mujore (në %)				
	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024
Totali i kredive	444,721	449,251	462,435	467,411	469,266	5.1	6.1	6.4	7.5	7.5	1.3	0.3	0.8	0.5	0.4
<i>nga të cilat:</i>															
Sektori korporativ	212,768	214,268	221,765	224,112	223,900	3.3	5.4	5.8	8.1	7.5	2.2	0.0	0.6	0.5	-0.1
Në denarë	131,089	134,280	144,110	148,442	149,795	7.1	11.9	16.2	19.8	19.7	2.7	1.0	2.6	1.7	0.9
Në valutë të huaj	81,679	79,988	77,656	75,670	74,104	-2.3	-3.9	-9.3	-9.3	-10.9	1.4	-1.7	-2.8	-1.6	-2.1
Amvisëritë	229,404	232,313	238,057	240,911	242,919	6.7	6.8	7.1	7.2	7.7	0.5	0.5	1.0	0.4	0.8
Në denarë	125,223	126,809	130,453	132,110	133,210	5.1	5.8	7.2	7.0	7.6	0.0	0.3	1.2	0.3	0.8
Në valutë të huaj	104,180	105,504	107,603	108,802	109,709	8.8	8.1	7.0	7.4	7.8	1.2	0.6	0.7	0.6	0.8


Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



1. Depozitat dhe kreditë të sektorit korporativ ⁴





Burimi: BPRMV.

⁴ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin shoqëritë publike dhe private jofinanciare..




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Në shtator, totali i **depozitave të sektorit korporativ** shënoi rënie prej 0,5%. Ndryshimi në rënie është kryesisht rezultat i uljes së depozitave afatshkurtra në valutë të huaj dhe denarë, në kushtet e rritjes së parave të depozituara dhe depozitave afatgjata. Në bazë vjetore vërehet rritje prej 4,7%, kryesisht për shkak të rritjes së parave të depozitave, me rritjen e depozitave afatgjata në valutë të huaj dhe në denarë dhe depozitave afatshkurtra në denarë, ndërsa depozitat afatshkurtra në valutë të huaj shënuan rënie
- Kreditë e sektorit korporativ**⁵, në shtator ata arritën ulje minimale mujore prej 0,1% që është tërësisht rezultat i rënies së kreditimit në valutë të huaj, gjatë rritjes së kredive në denarë. Krahasuar në bazë vjetore, kreditë e sektorit korporativ shënuan rritje prej 7,5%, që rezultojnë nga rritja e kreditimit në denarë, gjatë rënies së kreditimit në valutë të huaj.



Burimi: BPRMV.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁶



Burimi: BPRMV.



⁵ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁶ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe të ekzekutuesve të pavarur të veprimtarisë




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

- Në shtator, **totali i depozitave të amvisërive** shënoi rritje prej 0,1% në bazë mujore, i ndikuar tërësisht nga rritja e depozitave afatgjata në denarë dhe valutë të huaj, në kushtet kur paratë e depozituara dhe depozitat afatshkurtra në valutë të huaj dhe denarë shënuan rënie. Rritja vjetore është 11,2% dhe rezulton nga rritja e parave të depozituara dhe depozitave afatgjata në denarë dhe valutë të huaj, gjatë rënies së depozitave afatshkurtra.
- Kreditë e amvisërive**, në shtator, janë më të larta për 0,8% dhe 7,7% në baza mujore, respektivisht vjetore. Rritja në të dyja bazat është rezultat i rritjes së kredive në denarë dhe në valutë të huaj, me kontribut më të madh të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Tabela 2. Kreditë e bankave dhe kursimoreve të dhëna për personat fizikë, sipas qëllimit⁷

	gjendja (në milionë denarë)					ndryshimet vjetore (në %)					ndryshimet mujore (në %)				
	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024	12.2023	3.2024	6.2024	8.2024	9.2024
Kreditë konsumatore	119,868	119,858	122,857	124,427	125,233	6.5	5.8	5.8	6.4	6.7	1.1	0.4	0.8	0.3	0.6
Kreditë për banesa	83,891	85,555	87,920	89,278	90,191	10.5	10.4	10.2	10.8	11.0	1.4	1.0	0.9	0.8	1.0
Kreditë për automjete	399	399	419	432	430	11.4	13.1	14.6	12.5	13.5	2.7	1.8	2.1	3.3	-0.6
Kartat e kreditit	9,835	9,459	9,332	9,258	9,184	-4.7	-6.8	-8.0	-8.9	-9.0	-1.9	-0.8	-0.3	-0.6	-0.8
Bilancet negative të llogarive rrjedhëse	6,000	6,820	6,846	6,555	6,857	0.6	6.1	7.9	-7.3	-1.9	-13.8	2.3	5.7	-3.3	4.6
Kreditë e miratuara mbi baza të tjera	1,782	1,658	1,579	1,552	1,563	-19.3	-21.2	-18.8	-19.5	-17.5	-2.5	-1.7	-2.0	-1.7	0.7

Burimi: BPRMV.

- Analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizik, në muajin shtator, në kategoritë më të përfaqësuara - **kreditë konsumatore dhe banesore** është shënuar rritje mujore prej 0,6%, përkatësisht 1,0%, me rritje vjetore prej 6,7%, përkatësisht 11,0%. Këtë muaj, **kreditë për automjete** u ulën për 0,6% në bazë mujore, ndërsa në nivel vjetor janë rritur për 13,5%. Kreditë e miratuara për **kartelat kreditore**, në shtator shënuan rënie mujore dhe vjetore prej 0,8%, respektivisht 9,0%. Në shtator, **bilancet negative të llogarive rrjedhëse** dhe kreditë e miratuara **në baza tjera** shënuan rritje mujore prej 4,6%, përkatësisht 0,7%, ndërsa në bazë vjetore shënuan rënie prej 1,9%, përkatësisht 17,5%.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore: https://www.nbrm.mk/monetarna_statistika-al.nspx

Shpjegime metodologjike:

[Metodologjia monetarna 07 2021 al.pdf \(nbrm.mk\)](#)

Informacioni për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

⁷ Në tetor 2024, është bërë rishikim i të dhënave për kredinë konsumatore dhe për makina, për periudhën maj 2024 - gusht 2024, sipas të dhënave të sapomarra nga lajmëruesit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e Statistikës

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 nëntor 2024 (mesatare referuese, përfshirë tetorin e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235 lok. 108/110.